

TERMAT E REFERENCËS

Thirrje e hapur për shërbime auditimi për ofrimin e shpenzimeve të kontrates.

Institucioni përfitues: Agjencia Kombëtare e Rinisë (PP02), Shqipëri

Emri i projektit: EU4Youth Grant Scheme

Programi i financimit: **IPA III – EU for Youth 2022**

Instrumenti i politikës i adresuar: Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022–2029, Strategjia e Rinisë e Bashkimit Evropian 2022-2027.

Data e përfundimit të kontratës: Prill 2026 (kohëzgjatja totale e kontratës 24 muaj)

Vendi i angazhimit: **Tiranë / punë në distancë sipas nevojës**

Raportimi: Drejtori i Përgjithshëm i AKR

1. Konteksti i projektit

Projekti kontribuon drejtpërdrejt në objektivin e Programit EU4Youth në Shqipëri për të rritur pjesëmarrjen politike, ekonomike dhe sociale të të rinjve përmes fuqizimit social, angazhimit qytetar dhe përmirësimit të mirëqenies. Ai zbaton Fushën e Mbështetjes 1 të Dokumentit të Veprimit EU4Youth – “Pjesëmarrja qytetare e të rinjve, të drejtat e njeriut për të rinjtë, vullnetarizmi dhe përfshirja e tyre në zhvillimin e komunitetit, kulturë dhe sport” – përmes krijimit të një Skeme Kombëtare të Granteve të menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR). Veprimi bazohet në dy objektiva kryesore, në përputhje me shtyllat e Strategjisë së BE për Rininë 2022–2027 (Engage – Connect – Empower) dhe Planin e Veprimit për Rininë në Veprimin e Jashtëm të BE 2022–2027.

2. Qëllimi i pozicionit

Qëllimi i angazhimit të audituesit të jashtëm është të kryejë një auditim të pavarur financiar dhe të përputhshmërisë për projektin e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për të siguruar përputhshmëri të plotë me rregulloret financiare të BE-së dhe për të rritur llogaridhënien dhe transparencën gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, parashikohet angazhimi i shërbimeve të auditimit të jashtëm.

Shërbimi i auditimit do të jetë përgjegjëse për kryerjen e një auditimi verifikimi financiar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e grantit dhe standardet përkatëse të auditimit të BE-së. Auditimi do të verifikojë të drejtën, saktësinë dhe dokumentimin e shpenzimeve të projektit, do të vlerësojë kontrollat e brendshme dhe do të ofrojë siguri se fondet janë përdorur në përputhje me buxhetin e miratuar dhe detyrimet kontraktuale.

Auditimi synon të sigurojë që:

- shpenzimet e raportuara janë reale, të justifikuara dhe të dokumentuara;
- fondet janë përdorur në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive;
- procedurat financiare dhe të prokurimit janë zbatuar sipas rregullave të BE-së dhe legjislacionit shqiptar.

3. Detyra dhe përgjegjësi

Ofruesi i shërbimit të auditimit duhet do të kryejë këto detyra kryesore:

3.1 Auditimi Financiar

- Të verifikojë pasqyrat financiare të projektit dhe raportet financiare të paraqitura.
- Të kontrollojë që shpenzimet e raportuara përputhen me buxhetin e miratuar të projektit.
- Të verifikojë dokumentacionin mbështetës (fatura, kontrata, lista pagesash, prova pagesash, etj.).
- Të konfirmojë që shpenzimet janë të pranueshme sipas rregullave të projektit dhe financuesit.

3.2 Verifikimi i Përputhshmërisë

- Të kontrollojë nëse menaxhimi financiar i projektit është kryer në përputhje me:
 - marrëveshjen e financimit,
 - rregullat e BE-së dhe procedurat e CFCU,
 - legjislacionin financiar kombëtar.
- Të verifikojë procedurat e prokurimit dhe kontraktimit të kryera në kuadër të projektit.

3.3 Kontrolli i Sistemeve të Menaxhimit Financiar

- Të vlerësojë sistemet e kontrollit të brendshëm financiar të përdorura për menaxhimin e projektit.
- Të identifikojë dobësitë ose risqet në menaxhimin financiar dhe administrativ

4.4 Raportimi

- Të përgatisë një Raport Auditimi që përfshin:
 - opinionin e audituesit mbi pasqyrat financiare të projektit,
 - gjetjet kryesore të auditimit,
 - rekomandime për përmirësimin e menaxhimit financiar.
- Të dorëzojë raportin përfundimtar te institucioni përfitues dhe te autoritetet përkatëse sipas kërkesave të projektit.

4.5 Bashkëpunimi me Institucionin Përfitues

- Të bashkëpunojë me stafin e projektit dhe të kërkojë çdo dokument apo informacion të nevojshëm për realizimin e auditimit.
- Të ruajë konfidencialitetin e të dhënave dhe dokumenteve të projektit.

5. Pajisjet

Nuk do të blihet pajisje sipas kësaj kontrate. Çdo mjet, pajisje ose softuer që përdoret për realizimin e detyrës duhet të sigurohet dhe mirëmbajtet nga kontraktori.

6. Kualifikime

Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë një nga kushtet e mëposhtme

- është anëtar i një organi ose institucioni kombëtar të kontabilitetit ose auditimit, i cili nga ana e tij është anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC).
- është anëtar i një organi ose institucioni kombëtar të kontabilitetit ose auditimit. Megjithatë ky organizatë nuk është anëtar i IFAC-ut, Praktikuesi angazhohet të kryejë këtë detyrë në përputhje me standardet dhe etikën e IFAC-ut të përcaktuara në këto Kushte të Referencës.
- është i regjistruar si auditor ligjor në regjistrin publik të një organi publik mbikëqyrës në një shtet anëtar të BE-së, në përputhje me parimet e mbikëqyrjes publike të përcaktuara në Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit (kjo vlen për auditorët dhe firmat e auditimit me bazë në një shtet anëtar të BE-së).
- është i regjistruar si auditor ligjor në regjistrin publik të një organi publik mbikëqyrës në një vend të tretë dhe ky regjistër i nënshtrohet parimeve të mbikëqyrjes publike të përcaktuara në legjislacionin e vendit përkatës (kjo vlen për auditorët dhe firmat e auditimit me bazë në një vend të tretë).

* Të gjithë ekspertët duhet të jenë të pavarur dhe të lirë nga konflikti i interesit në funksionet që kryejnë sipas kësaj kontrate.

7. Dokumentet që duhet të dorëzohen

Kandidati duhet të aplikojë me:

- CV të përditësuar (preferohet format Europass)
- Shprehje interesi duke argumentuar plotësimin e kritereve
- Kopje të diplomave/certifikatave
- Dokumente që dëshmojnë eksperiencën në auditim/verifikim financiar
- Emrat dhe kontaktet e 2 personave që mund të shërbejnë si referencë personale

8. Mënyra e aplikimit dhe afati

Aplikimet duhet të dërgohen në adresën zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Rinisë:

info@rinia.gov.al

9. Kohëzgjatja dhe vendndodhja

- Kontrata fillon në Prill 2026 dhe në linjë me kohëzgjatjen e projektit mund të mbarojë në Prill 2028. (e ndryshueshme në varësi të afateve të projektit)
- Eksperti mund të punojë në distancë, por takime të herëpashershme me stafin e projektit mund të kërkohen në Tiranë.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve 17 Mars 2026. Aplikimet dërgohen tek info@rinia.gov.al